

DOKUMENT AVOKUES

Të drejtat gjuhësore në praktikë Pse veprimi i përbashkët nuk mund të presë



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

Misioni i OSBE-së në Kosovë (Misioni) monitoron dhe mbështet zbatimin e të drejtave gjuhësore në Kosovë, në përputhje me mandatin e tij për promovimin e të drejtave të njeriut, llogaridhënien institucionale dhe gjithëpërfshirjen. Kushtetuta¹ dhe Ligji për përdorimin e gjuhëve² garantojnë statusin e barabartë të gjuhëve shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare dhe përcaktojnë përdorimin e gjuhëve të tjera të komuniteteve në nivel komunal. Përkundër këtij kuadri të fortë ligjor, ende në praktikë ka mangësi dhe mosrespektime të vazhdueshme. Si rrjedhojë, të drejtat gjuhësore vazhdojnë të jenë çështje prioritare që kërkojnë vëmendje dhe mbështetje të shtuar.

Në këtë dokument janë paraqitur boshllëqet kryesore dhe fushat prioritare që kërkojnë mbështetje. Qëllimi i tij është t'i orientojë Misionin dhe partnerët ndërkombëtarë në mbështetjen e institucioneve përgjegjëse për forcimin e pajtueshmërisë, llogaridhënies dhe mbrojtjes efektive të të drejtave gjuhësore dhe shumëgjuhësisë në Kosovë.

Dokumenti bazohet në monitorimin e Misionit të realizuar ndërmjet prillit 2023 dhe qershorit 2025 në të 38 komunat, duke përfshirë angazhimin me personat kontaktues komunalë për gjuhët, përkthyesit, mekanizmat për pjesëmarrjen e komuniteteve, zyrat për informim, zyrtarët ligjorë dhe zyrtarët për integritet evropian. Këto vëzhgime ofrojnë një pasqyrë të bazuar në dëshmi mbi sfidat strukturore që ndikojnë në zbatimin efektiv të të drejtave gjuhësore dhe shumëgjuhësisë në nivel komunal.

SFIDAT KRYESORE

Vonesat dhe mangësitë në zbatimin e të drejtave gjuhësore vazhdojnë të cenojnë qasjen e barabartë në shërbimet publike, pjesëmarrjen në jetën publike dhe komunikimin me institucionet, veçanërisht për komunitetet joshumicë. Nëse nuk adresohen, këto sfida mund të dobësojnë besimin në institucionet publike, të ndikojnë negativisht në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve dhe të pengojnë zhvillimin e një shoqërie shumëgjuhëshe, të larmishme dhe gjithëpërfshirëse.

Mbështetja për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët

Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) ka rol kyç mbikëqyrës dhe këshillëdhënës, por burimet në dispozicion të saj janë të pamjaftueshme për ta ushtruar plotësisht mandatin e saj dhe për të garantuar pajtueshmëri institucionale. Mungesa e Komisionerit për Gjuhët, që nga janari 2025,³ kufizon mbikëqyrjen institucionale dhe llogaridhënien publike. Kjo reflektohet në komunikim jo të njëtrajtshëm me komunat,⁴ dhe në ndjekje të kufizuar të rekomandimeve të lëshuara nga ZKGJ-ja, duke dobësuar kështu zbatimin në nivel lokal.⁵

Emërimi i personave kontaktues komunalë për gjuhët

Personat Kontaktues për Gjuhët (PKGJ) koordinojnë proceset thelbësore për të siguruar pajtueshmërinë e komunave me legjislacionin për gjuhët, përfshirë ofrimin e shërbimeve për banorët, interpretimin dhe përkthimin e dokumenteve publike në gjuhët e përcaktuara me ligj. Pavarësisht kërkesës së përcaktuar në Rregulloren për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët,⁶ vetëm 22 nga 38 komuna kanë emëruar PKGJ. Vetëdijesimi i kufizuar, pengesat administrative dhe kufizimet politike vazhdojnë të pengojnë këtë pajtueshmëri.

¹ Kushtetuta e Kosovës, Neni 5 [Gjuhët] dhe Neni 59 [Të Drejtat e Komuniteteve dhe Anëtarëve të Tyre].

² Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve.

³ Rekrutimi ishte në proces në kohën e hartimit; më 19 qershor 2026, u emërua Komisioni i Pranimi për këtë pozitë.

⁴ Gjatë periudhës së raportimit, 17 nga 38 komuna raportuan se nuk kishin kontakt me ZKGJ-në.

⁵ Tri komuna konfirmuan se kishin marrë rekomandime mbi pajtueshmërinë gjuhësore, nga të cilat një mbeti e pazgjidhur gjatë periudhës së raportimit.

⁶ Rregullorja Nr. 07/2012 për Zyrën e Komisionerit të Gjuhëve, Neni 15.

Disponueshmëria e interpretëve dhe mundësitë arsimore

Komunat shpeshherë mbështeten në zgjidhje të atypëratyshme dhe angazhime të përkohshme si pasojë e mungesës së interpretëve të kualifikuar dhe mungesës së programeve të qëndrueshme të edukimit dhe trajnimit për profesionistët e rinj. Si pasojë, shërbimet në gjuhët e komuniteteve joshumicë nuk ofrohen në mënyrë të mjaftueshme. Përderisa shërbimet në gjuhën serbe përgjithësisht janë të disponueshme, ofrimi i shërbimeve në gjuhët boshnjake, turke dhe rome mbetet kryesisht i parregullt.⁷

Afatet e përkthimit dhe ngarkesa e punës

Kufizimet në kapacitete dhe numri i pamjaftueshëm i stafit shkaktojnë vonesa dhe mangësi të shpeshta në përkthim dhe interpretim. Cilësia e pajisjeve dhe teknologjive në dispozicion mbetet e pamjaftueshme në shumicën e komunave.⁸ Komunat më të mëdha shumëgjuhëshe përballen me ngarkesë veçanërisht të lartë pune, gjë që ndikon drejtpërdrejt në qasjen në kohë në informata, dokumente publike dhe shërbime për komunitetet joshumicë, si dhe në pjesëmarrjen e publikut në të gjitha gjuhët zyrtare.

Ndërgjegjësimi i publikut dhe përdorimi i mekanizmave të ankesave

Ndërgjegjësimi i publikut për të drejtat gjuhësore dhe mekanizmat në dispozicion për paraqitjen e ankesave mbetet shumë i ulët. Gjatë periudhës raportuese, në ZKGJ u dorëzua vetëm një ankesë zyrtare nga banorët lidhur me mosrespektimin e detyrimeve gjuhësore nga komuna. Besimi i kufizuar i publikut në institucionet përgjegjëse dhe vetëdija e ulët për të drejtat gjuhësore rezultojnë në raportim të pakët të shkeljeve

AKTIVITETI I MISIONIT TË OSBE-SË NË KOSOVË

Misioni i OSBE-së në Kosovë do të vazhdojë t'i mbështesë institucionet për të përmirësuar zbatimin e legjislacionit për gjuhët përmes monitorimit, angazhimit në politika dhe ngritjes së kapaciteteve. Duke forcuar koordinimin ndërinstitutional, duke avokuar për rritjen e mbështetjes për kapacitetet e përkthimit dhe interpretimit, si dhe duke rritur ndërgjegjësimin e komuniteteve, Misioni do të kontribuojë në mbrojtjen dhe promovimin më efektiv të të drejtave gjuhësore në Kosovë.



THIRRJE PËR VEPRIM

Zbatimi efektiv i të drejtave gjuhësore është thelbësor për të garantuar qasje të barabartë në shërbimet publike dhe për të nxitur kohezionin shoqëror në një shoqëri shumëgjuhëshe dhe shumetnike. Megjithatë, pa burime shtesë, staf të mjaftueshëm dhe ngritje sistematike të kapaciteteve, komunat do të vazhdojnë të përballen me sfida në zbatimin e plotë të kuadrit ligjor në fuqi.

⁷ Mungesa e përkthyesve të dedikuar u vu re në: Klinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Mamushë, Skenderaj dhe Hani i Elezit për gjuhën serbe; në Mitrovica Jugore dhe Vushtrri për gjuhën turke; dhe në Prizren dhe Graçanicë për gjuhën rome

⁸ Bazuar në reagimet e përsëritura të dhëna Misionit nga përkthyesit dhe interpretët komunalë gjatë punëtorive dhe takimeve të mbajtura gjatë viteve 2024 dhe 2025 në të gjitha rajonet.

ÇFARË MUND TË BËJNË PARTNERËT NDËRKOMBËTARË

Adresimi i sfidave të vazhdueshme kërkon angazhim të ripërtërirë institucional dhe mbështetje të qëndrueshme nga partnerët ndërkombëtarë. Sinergjia ndërmjet partnerëve ndërkombëtarë dhe iniciativat e koordinuara janë thelbësore për të ofruar avokim efektiv, asistencë teknike dhe mbështetje financiare për institucionet përgjegjëse.

1

Mbështetja për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët dhe koordinimin ndërinstitutional

- Të vazhdohet avokimi i koordinuar me Zyrën e Kryeministrit për të siguruar burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore për Zyrën, përfshirë emërimin e Komisionerit për Gjuhët.
- Të ndihmohet në identifikimin e zgjidhjeve për forcimin e koordinimit të rregullt ndërmjet Zyrës së Komisionerit për Gjuhët dhe komunave (përfshirë komunat veriore), duke siguruar mbikëqyrje të qëndrueshme, ndjekje sistematike të rekomandimeve dhe llogaridhënie efektive.
- Të ofrohet mbështetje teknike për Zyrën e Komisionerit për Gjuhët në mënyrë që të zhvillohen aktivitete të rregullta informuese dhe ndërgjegjësuere për të gjitha komunitetet.

2

Avokimi për disponueshmërinë e interpretëve dhe mundësitë për edukim

- Së bashku të avokohet për rekrutimin në kohë të përkthyesve dhe interpretëve të kualifikuar me pozita të përhershme në komuna.
- Të bashkëpunohet me institucionet dhe partnerët përkatës për zhvillimin e programeve të qëndrueshme të edukimit dhe certifikimit për përkthyes dhe interpretë.
- Të lehtësohen dhe/ose financohen mundësi të zhvillimit profesional për përkthyesit dhe interpretët.
- Të promovohet futja e mësimi të ndërsjellë të gjuhëve zyrtare në shkolla për të nxitur dygjuhësinë dhe mirëkuptimin ndërkulturor.

3

Inkurajimi i emërimit të personave kontaktues komunalë për gjuhët

- Të avokohet pranë institucioneve komunale për emërimin e Personave kontaktues për gjuhët të kualifikuar dhe funksionalë në të gjitha komunat.
- Të avokohet për ofrimin e trajnimeve të targetuara për stafin komunal mbi përgjegjësitë që kanë të bëjnë me të drejtat gjuhësore, detyrimet ligjore dhe praktikat më të mira.

4

Promovimi i afateve të balancuara të përkthimit dhe ngarkesës së punës

- Të avokohet për vendosjen e afateve të qarta për përkthim dhe standardeve të cilësisë.
- Të mbështetet financiarisht sigurimi i pajisjeve teknike dhe teknologjive moderne të përkthimit për të përmirësuar saktësinë, konsistencën dhe ofrimin në kohë të shërbimeve.

5

Rritja e ndërgjegjësimit publik për të drejtat gjuhësore dhe mekanizmat e ankesave

- Të mbështetet zbatimi i fushatave të targetuara të ndërgjegjësimit publik për të drejtat gjuhësore, institucionet përgjegjëse dhe mekanizmat ekzistues të ankesave.
- Të mbështetet Zyra e Komisionerit për Gjuhët për të përmirësuar qasshmërinë, reagimin në kohë dhe dukshmërinë e mekanizmave të ankesave.
- Të fuqizohet shoqëria civile për të mbështetur aktivitetet informuese dhe ndërgjegjësuere, veçanërisht për komunitetet joshumicë.